



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PLANI VJETOR 2024

Plani vjetor i auditimit të brendshëm është hartuar mbështetur në Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin Publik”, aktet nënligjore në zbatim të tij, Kartën e auditimit të brendshëm si dhe Standardet kombëtare të auditimit.

I.Zhvillimet aktuale të veprimtarisë audituese

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) është e orientuar nga objektivat e Ministrisë si dhe nga detyrimet që përcakton ligji për auditimin e brendshëm, në funksion të përmirësimit të menaxhimit të fondeve publike dhe përdorimit të tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri.

Gjatë vitit 2023 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MEPJ, ka organizuar punën për një përdorim efektiv të burimeve në dispozicion në funksion të arritjes së objektivave. Për periudhën 9 mujore janë realizuar 6 auditime nga të cilat 5 auditime të plota dhe 1 auditim tematik, 4 auditime janë në proces.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese edhe gjatë këtij viti, kanë qënë vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut, nëse:

- Veprimtaritë e përfaqësive janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet publike janë ruajtur dhe përdorur me efektivitet;
- Informacionet financiare, janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur

II.Objektivat e auditimit të brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2024

- Rritja e efektivitetit dhe efijencës së shërbimeve të auditimit duke realizuar të gjitha angazhimet e programuara në planin vjetor.
- Rritja e cilësisë së raportimeve si dhe kryerja e tyre brenda afateve.
- Përmirësimi i cilësisë rekomandimeve me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së MEPJ dhe të subjekteve të vartësisë lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm, kontrollet e drejtimin, të performancës dhe të vlerësimit.
- Minimizimi i kostove të auditimit duke u përqëndruar në sisteme apo fusha më risk të lartë dhe të mesëm.

- Ngritja profesionale e stafit të DAB përmes trainimeve të vazhdueshme.

Në hartimin e planit vjetor të punës janë vlerësuar risqet mbi bazë sistemi si dhe risqe të tjera lidhur me kriteret e mëposhtme:

- Afati i mos ushtrimit të auditimeve në Përfaqësitë Diplomatike e Konsullore.
- Përfaqësitë që kanë aktivitet të zgjeruar ekonomik-financiar dhe konsullor.
- Ndryshimi i personelit në përfaqësi, veçanërisht personeli që ka përgjegjësi monetare dhe materiale (titullari i Përfaqësisë, i ngarkuari me financën, etj)
- Mundësia për të audituar dy Përfaqësi brenda një udhëtimi me qëllim shkurtimin e kohës së auditimit dhe të rrugëve vajtje-ardhje.
- Shfrytëzimi maksimal i kohës së auditimit nëpër Përfaqësi, me qëllim reduktimin e shpenzimeve për ditë qëndrimi në vendet përkatëse.

Në planin për vitin 2024 janë planifikuar angazhime auditimi në aparatën e MEPJ për sisteme të veçanta, krahas atyre tradicionale, që lidhen me proceset e qeverisjes dhe menaxhimit, apo sisteme të tjera, si detyrimet e prapambetura, statusi i zbatimit të rekomandimeve etj, këto në ndjekje të rekomandimeve të dhëna edhe nga ekspertët e BE.

III. Programimi i llojit të angazhimeve :

- Marrja e informacionit në lidhje me veprimtarinë e njësive që do të auditohen si në aparatën e MEPJ-së ashtu edhe në subjektet e vartësisë.
- Përpunimi i informacionit të marrë paraprakisht dhe përgatitja e programeve të auditimit të subjekteve dhe aktiviteteve që do të auditohen.
- Proçesi i auditimit të aktiviteteve të vlerësuara më parë për auditim.
- Vlerësimi i veprimtarisë së subjekteve dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim përmirësimin e këtij sistemi dhe këtyre praktikave, për të shmangur rrisqet e mundshme në lidhje me arritjen e objektivave.
- Hartimi i projekt raporteve dhe raporteve finale.
- Dhënia e rekomandimeve të vlerësuara si të dobishme në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Frekuenca e auditimeve :

Duke marrë parasysh problematikën e secilës njësi auditimi, risqet e subjektit në proçesin e realizimit të objektivave si dhe për të shmangur risqet që vijnë nga mos kryerja e auditimeve përcaktohet një raport optimal midis këtyre faktorëve dhe frekuencës së auditimeve.

Gjatë vitit 2024 numri i auditimeve parashikohet të jetë 17. Në këtë plan janë përfshirë subjekte të paaudituar për një periudhë 3-4 vjecare, duke arritur një përmirësim të ndjeshëm në frekuencën e auditimeve 3-4 vite. Numri i ditëve të misionit të auditimit në subjekt për një angazhim auditimi varion nga 4-6 ditë në varësi të ngarkesës së punës dhe frekuencës së auditimeve.

Risqet e jashtme që kufizojnë realizimin e programit të auditimit :

- Ndryshimi i prioriteteve nga menaxhimi i lartë.

- Mungesa e fondeve buxhetore.
- Mos përputhja në kohë midis angazhimeve të auditimit sipas planit vjetor të miratuar nga Ministri me angazhimet diplomatike të përfaqesive që do të auditohen.
- Nryshimi i vazhdueshëm i stafit diplomatik dhe teknik në përfaqësi.
- Largësia fizike e subjekteve që auditohen.
- Mungesa e njohurive profesionale të personelit që është ngarkuar me kryerjen e veprimeve financiare në subjektet që auditohen.

Risqet e brendshme në kuadër të planit të auditimit

1. Ndryshimi i strukturës së DAB.
2. Konflikti i interesave mes të audituarve dhe audituesve.
3. Mungesa e pavarësisë dhe objektivitetit nga audituesit e brendshëm si rezultat i ndërhyrjeve nga jashtë ose nga menaxherët e lartë
4. Mungesa e kualifikimit të stafit të auditimit të brendshëm, veçanërisht për auditimin e sistemeve të IT dhe fondet IPA

IV. Planifikimi i kostos për vitin 2024(pasqyra nr.5)

Një nga fazat e përgatitjes së planit vjetor është planifikimi i burimeve sipas nevojave të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për kryerjen e veprimtarisë së saj si dhe llogaritja e kostove përkatëse.

Në llogaritjen e kostos së AB për vitin e ardhshëm janë marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Burimet njerëzore në dispozicion të AB.
- Shpenzimet për paga llogaritur mbi bazën e pagës mesatare mujore (duke marrë në konsideratë rritjen gjatë vitit 2023 por edhe atë të planifikuar për vitin 2024)
- Shpenzime operative

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 (në mijë lekë)					
Buxheti Gjithsej	Paga dhe Sig. Shoqërore	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	Të tjera	Numri i Punonjësve	Kosto mesatare për Person(1/5)
14300	9500	4000	800	5	2860

V. Burimet për auditimin e brendshëm :

Kryerja me efektivitet të angazhimeve të auditimit të brendshëm kërkon një shpërndarje sa më të mirë të burimeve që janë në dispozicion. Këto burime përfshijnë burimet njerëzore dhe burime materiale.

Burimet njerëzore klasifikohen në burime të brendshme dhe burime të jashtme.

- Burimet e brendshme janë kapacitetet njerëzore dhe profesionale të cilat njëzia e auditit i ka në dispozicion të përhershëm
- Burimet e jashtme janë personel i aktivizuar në auditim nga struktura të tjera brenda MEPJ-së ose jashtë saj për sisteme të veçanta
- Burimet materiale janë kapacitetet financiare dhe materiale për kryerjen e misionëve të auditimit.

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së angazhimeve të auditimit merret në konsideratë niveli i riskut dhe kompleksiteti i sistemeve /fushave të llogarisë ku për sistemet me komplekse dhe me risk më të lartë është vënë një kohë me madhe në dispozicion për auditim.

VI.Përmirësimi i kapaciteteve audituese :

Zhvillimet e reja në fushën e auditimit të brendshëm lidhur me ndryshimet ligjore dhe përafrimin sa më të madh me praktikën dhe standardet ndërkombëtare kërkojnë rritjen e cilësisë së punës audituese gjë që arrihet përmes rritjes së kualifikimeve personale. Përmirësimi i kapaciteteve audituese do të realizohet nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë përsa i takon trainimit të detyrueshëm për audituesit e brendshëm që realizohet çdo vit, por edhe nga ASPA me trainime të ndryshme që ofron on line.

VII.Sigurimi i cilësisë

Monitorimi i punës së auditimit të brendshëm realizohet në bazë të Programit të Sigurimit të Cilësisë me qëllim që të konfirmohet që puna është kryer sipas standardeve të AB dhe raportet janë hartuar në përputhje me manualin e AB dhe mbështeten nga evidenca të detajuara të auditimit. Rishikimi i brendshëm i cilësisë realizohet përmes komponentëve të sigurimit të brendshëm të cilësisë të përcaktuara në Program.

- Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- Vetë-vlerësim periodik të praktikave të auditimit të brendshëm
- Marrja e reagimeve (Feedback-un) pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Sigurimi i cilësisë realizohet edhe përmes vlerësimit të performancës së aktivitetit vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm bazuar në indikatorët e performancës, të cilët pasqyrojnë arritjet kryesore të këtij shërbimi:

1. Vlerësimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin
2. Realizimi i Planit vjetor të Auditimit
3. Pranimi i rekomandimeve
4. Zbatimi i rekomandimeve
5. Trainimi i stafit të njësisë së auditimit
6. Vlerësimi i monitorimit të vazhdueshëm
7. Vlerësimi i subjekteve të audituara
8. Vetëvlerësimi periodik

Të tjera. Plani vjetor, si pjesë e planit strategjik, është një dokument që identifikon veprimtarinë audituese të DAB në sistemin e MEPJ për vitin 2024. Ky plan është një dokument fleksibël që vepron në një ambient që ndryshon duke reflektuar prioritetet në kuadrin e këtyre ndryshimeve.